

2021

Raporti i Simpoziumit:

E ARDHMJA E PLANIFIKIMIT TERRITORIAL NË KOSOVË



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
në partneritet me UN-Habitat Kosova



MOHIMI I PËRGJEGJËSISË

Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin juridik të çfarëdo vendi, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tij. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara mbi Vendbanimet Njerëzore, të Kombeve të Bashkuara ose të Shteteve Anëtare të tij. Fragmentet mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi.

Për UN-Habitat, të gjitha referencat ndaj Kosovës duhet të kuptohen se janë në kontekstin e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2021

Fotografitë, hartat dhe diagramet e përdorura në këtë raport janë pronë e organizatorëve të simpoziumit, **Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)** dhe **UN-Habitat Kosova**, nëse nuk konstatohet ndryshe. Ato mund të riprodhohen me kusht që burimi të printohet me fotografi, harta ose diagrame.

Programi i Kombeve të Bashkuara mbi Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat) Kosovë
Ndërtesa e Ministrive "Rilindja", Kati i 10-të
10000 Prishtinë, Kosovë
www.unhabitat.org
www.unhabitat-kosovo.org

FALËNDERIME

AUTORE e RAPORTIT:

Fjollë Caka (UN-Habitat Kosova)

RISHIKUES:

Liburn Aliu (MMPHI), Omar Siddique (UN-Habitat Kosova), Gylter Mydyti (ETH Zurich)

KONTRIBUES të TJERË:

Rineta Jashari (MMPHI), Gearda Demiraj (MMPHI), Esidora Ismajli (MMPHI), Besnike Koçani (UN-Habitat Kosova), Luan Nushi (IPH/MMPHI), Arta Bytyqi, (UN-Habitat Kosova), Alma Paçarizi (UN-Habitat Kosova), Blerina Boshnjaku (UN-Habitat Kosova), Bleona Kuleta (MMPHI), Artina Arifi (MMPHI), Arlinda Rexhepi (MMPHI), Dragoljub Stašić (UN-Habitat Kosovo)

FAQOSJA dhe DIZAJNI:

Fjollë Caka (UN-Habitat Kosova)

DIZAJNI i KOPERTINËS:

Blerina Boshnjaku (UN-Habitat Kosova)



PËRMBAJTJA

04

HYRJE

06

ZOTIME

10

PREZANTIME dhe DISKUTIME

11

Sesioni 1: Ristrukturimi institucional për një sistem më efektiv dhe të qëndrueshëm të planifikimit hapësinor

17

Sesioni 2: Qasja e planifikimit territorial për një zhvillim më të balancuar rural-urban

21

Sesioni 3: Planifikimi i integruar hapësinor, menaxhimi i tokës dhe banimi për zhvillim të qëndrueshëm

27

REZULTATET dhe HAPAT E ARDHSHËM



HYRJE

Të jetuarit nën kufizimet e vendosura si rrjedhojë e masave të marra kundër pandemisë COVID-19 e ka shtyrë Kosovën që t'i trajtojë problemet aktuale të planifikimit hapësinor në një shkallë planetare, duke i priorizuar qasjet më të qëndrueshme dhe duke i rimenduar territoret përtej kufijve tradicional administrativ. Ndikimet e reja socio-ekonomike kanë shkaktuar një ndryshim të kërkesës për banim, infrastrukturë të mobilitetit, hapësira të hapura, shërbime shëndetësore dhe arsimore, të cilat shtojnë për rimendimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit hapësinor përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke përfshirë politikëbërësit (e nivelit qendror dhe lokal), teoricienët (akademinë) dhe praktikuesit.

Përderisa Qeveria e sapoformuar e Kosovës zhvillon udhërrëfyesin e saj të veprimit, ky është një momentum për adresimin e pasojave territoriale (të integruara me ato ekonomike, sociale dhe mjedisore) të këtij fenomeni global, dhe për diskutimin e disa çështjeve themelore që lidhen me të ardhmen e planifikimit territorial dhe hapësinor në Kosovë.

Rrjedhimisht, **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)** në partneritet me **UN-Habitat Kosova**, organizoi simpoziumin një ditë me titull "**E ardhmja e Planifikimit Territorial në Kosovë**" më **25 qershor 2021**, ku u diskutuan në mënyrë aktive një gamë e gjerë e çështjeve ekzistuese dhe perspektivave të mundshme të së ardhmes (vizioni, qasjet, praktikat më të mira) ndërmjet institucioneve të nivelit qendror, akademisë dhe ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, përfaqësuesve të shoqërisë civile vendore, si dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë

Përveç organizatorëve të simpoziumit, MMPHI dhe UN-Habitat Kosova, të cilët mbikëqyrin drejtpërdrejt (Ministria) ose mbështesin (UN-Habitat Kosova) proceset e planifikimit hapësinor në Kosovë (ose rajone dhe komuna të veçanta), simpoziumi u mbështet edhe nga Zyra e Kryeministrit, Zyra Koordinuese për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara, dhe selia qendrore e UN-Habitatit.

Çështjet kryesore të diskutuara u grupuan në tri sesione, ku secili fillonte me një prezantim mbi çështjen e trajtuar dhe praktikat më të mira në kontekstin global, për t'u pasuar tutje me një panel diskutimi dhe diskutim të hapur drejt identifikimit të sfidave kryesore dhe rekomandimeve për zgjidhjet e mundshme të tyre.

Ky raport paraqet çështjet kryesore të prezantuara dhe diskutuara gjatë simpoziumit, përfshirë sfidat ekzistuese dhe zgjidhjet e mundshme të tyre drejt zhvillimit të qëndrueshëm territorial/hapësinor në Kosovë.





Sesioni 1: Ristrukturimi institucional për një sistem më efektiv dhe të qëndrueshëm të planifikimit hapësinor

Si të forcohen organizatat dhe kapacitetet institucionale kombëtare në nivele të ndryshme për të arritur një sistem të planifikimit hapësinor në Kosovë "të orientuar drejt qëllimit"?



Ms. Shipra Narang Suri
Chief, Urban Practices Branch
UN-Habitat Headquarters



Liburn Alliu
Minister of Environment,
Spatial Planning and Infrastructure



Shkelqim Daci
Swiss Development Cooperation



Elvira Pallaska
UBT - Higher Education Institution



Ilir Gjinolli
University of Prishtina



Samir Stagova
UN-Habitat Kosovo



Sesioni 2: Qasja e planifikimit territorial për një zhvillim më të balancuar rural-urban

Cilat janë zgjidhjet inovative që mund të forcojnë ndërlidhjet rurale-urbane për një planifikim territorial kombëtar më të balancuar në Kosovë?



Dr. Nazli Tümerdem
ETH Zurich



Sali Shoshi
Cultural Heritage
without Borders Kosovo



Afrim Lajci
Office of Prime Minister/
Swiss Cooperation Office



Hajrulla Ceku
Minister of Culture, Youth and Sport



Zenel Bunjaku
Initiative for Agricultural
Development of Kosovo



Zana Sokoli
UN-Habitat Kosovo



Sesioni 3: Planifikimi i integruar hapësinor, menaxhimi i tokës dhe banimi për zhvillim të qëndrueshëm

Si mund ta bëjmë planifikimin e integruar hapësinor, menaxhimin efektiv të tokës dhe sigurimin e banimit në shkallë të gjerë pjesë të mentalitetit dhe rutinës sonë të përgjithshme?



Dr. Jennifer Duyn Barenstein
ETH Zurich Wohnforum



Rozafa Badhe
University of Prishtina



Besvlla Kocani
UN-Habitat Kosovo



Driton Tafallari
Ministry of Environment,
Spatial Planning and Infrastructure



Urqan Abja
UBT - Higher Education Institution



Nita Liri
University of Prishtina



ZOTIME

Kryeministri, z. Albin Kurti, hapi Simpoziumin duke pohuar rëndësinë e qyteteve dhe duke bërë thirrje për mbështetjen e zhvillimit gjithëpërfshirës, të arritshëm dhe të barabartë të tyre, duke i vënë njerëzit në qendër të tyre dhe duke siguruar lidhje të qëndrueshme me mjediset e ndërtuara dhe natyrore. Duke marrë parasysh kërcënimet globale si ndryshimet klimatike dhe pandeminë COVID-19, si dhe nevojën për veprim të përbashkët drejt zhvillimit të gjelbër dhe mbrojtjes së planetit, tani është koha për të hapur një diskurs më të thellë dhe akademik rreth territorit, planifikimin dhe materializimin e tij, si dhe angazhimin e profesionistëve të fushave të ndryshme, shoqërisë civile dhe qytetarëve në një proces më gjithëpërfshirës të planifikimit.



"Krizat tilla si pandemitë, fatkeqësitë natyrore, krizat ekonomike, ngjarjet historike dhe proceset e tjera kanë qenë historikisht momente që kanë zhvilluar dhe formësuar qytetet dhe mjediset tona jetësore. [...] Tani, ndërsa po jetojmë në epokën Antropocene, në kohë sfidash të tilla si ndryshimi i klimës dhe shterimi i burimeve, mënyra se si reagojmë duhet të jetë duke synuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm, duke iu bashkuar lëvizjeve aktiviste për të kursyer burimet natyrore."

Albin Kurti



"Duke qenë në udhëkryq, është e rëndësishme ta shfrytëzojmë momentumin që është krijuar dhe të zhvillojmë diskutime të gjera se ku qëndrojmë në krahasim me objektivat tona dhe si po e organizojmë të ardhmen e planifikimit hapësinor në Kosovë. Diskutime profesionale dhe akademike (si ky simpozium) duhet të ndjekin gjithmonë proceset e planifikimit në Kosovë; ato duhet të paraprijnë dhe të sigurojnë që vendimet e duhura politike janë duke u marrë."

Liburn Aliu

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, prezantoi kornizën aktuale institucionale të planifikimit hapësinor në Kosovë, rolin e institucioneve qendrore (si Divizioni i Planifikimit Hapësinor brenda Ministrisë dhe Instituti për Planifikim Hapësinor) në nxitjen e zhvillimit hapësinor, dhe sfidat e vazhdueshme në zbatimin e planeve hapësinore në terren (përfshirë mungesën e të dhënave të sakta, kapacitetet e pamjaftueshme institucionale, si dhe procedurat komplekse që pengojnë proceset e zbatimit, të tilla si legalizimi dhe banimi). Marrja e vendimeve për të trajtuar këto çështje është e pashmangshme dhe vendime të tilla duhet të jenë inovative, proaktive dhe rezultat i diskutimeve të gjera. Duke theksuar rolin qendror të planifikimit hapësinor drejt zhvillimit të përgjithshëm kombëtar, Ministri u zotua për angazhim të menjëhershëm institucional në ndërtimin e një sistemi më efektiv të planifikimit hapësinor në Kosovë, duke hapur kështu diskutimin për vizionimin e planifikimit të ardhshëm territorial.

Koordinatorja e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, znj. Ulrika Richardson, shpjegoi planifikimin hapësinor si një mjet ndërmjetësimi për ndarjen e hapësirës, ndërtimin e vlerave të përbashkëta dhe mbështetjen e ndryshimeve transformuese; pra si mjeti më strategjik për të arritur qëndrueshmërinë. Hapësira është një çështje e pushtetit (kush e përdor dhe si), prandaj, proceset e planifikimit hapësinor duhet të jenë gjithëpërfshirëse, duke synuar arritjen e komuniteteve të qëndrueshme, të bashkuara dhe të shëndosha, duke u siguruar që askush të mos lihet anash (veçanërisht gratë dhe të rinjtë). Ekipi i OKB-së në Kosovë mbështet ambiciet dhe synimet e Kosovës përmes koordinimit ndërinstytucional dhe përpjekjeve të përbashkëta drejt zhvillimit të qëndrueshëm, me UN-Habitat Kosova si pikë qendrore për planifikimin hapësinor dhe territorial, zhvillimin urban dhe vendbanimet njerëzore që mbështesin një zhvillim më tërësor, të qëndrueshëm dhe të balancuar për njerëzit dhe mjedisin e Kosovës.



“Si familje prej 15 agjencish të OKB-së, ne kemi një kornizë të përbashkët bashkëpunimi të zhvilluar me partnerët tanë të ndryshëm: institucionet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, dhe do të bëjmë çmos për ta shoqëruar Kosovën drejt këtij rrugëtimi drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse në planifikimin dhe përdorimin e hapësirës, si një mjet drejt arritjes së drejtësisë sociale dhe arritjes së një ekuilibri më të mirë midis njerëzve (individit) dhe mjedisit.”

Ulrika Richardson



"Qytetet dhe rajonet në Ballkanin Perëndimor ndajnë histori të përbashkëta dhe modele të ngjashme hapësinore, duke luftuar me zhvillimet e çekuilibruara hapësinore, tkurrjen e ekonomive dhe stagnimin e vendbanimeve të vogla dhe të mesme. Ata duhet të gjejnë zgjidhje inovative për vendbanimet e planifikuara mirë dhe të menaxhuara mirë, të ndërtuara në procese pjesëmarrëse."

Omar Siddique

Shefi i Zyrës dhe Këshilltari Kryesor Teknik i UN-Habitat, z. Omar Siddique, dha disa mesazhe duke theksuar rëndësinë e perspektivës territoriale/hapësinore për zhvillimin e përgjithshëm të qëndrueshëm, duke e konsideruar atë si një mënyrë për organizimin e arsyeshëm të përdorimit të hapësirës dhe burimeve, për të priorizuar llojin e duhur të investimeve kombëtare (në infrastrukturë dhe shërbime publike), dhe për gjenerimin e pasurisë ekonomike. Zyra e UN-Habitat në Kosovë ka një histori të gjatë bashkëpunimi me institucionet në Kosovë në mbështetjen e proceseve të planifikimit hapësinor, së fundmi përmes Programit të Zhvillimit Gjithëpërfshirës të fokusuar në rajonin e Mitrovicës. Përmes Programit, shtatë komuna lokale mbështetën në zhvillimin e dokumenteve të tyre të planifikimit hapësinor (PZHK, HZK), planet sektoriale (PMQU), planet me bazë në komunitet dhe projektet e investimeve kapitale përmes proceseve pjesëmarrëse, duke synuar t'i bëjnë vendbanimet njerëzore më gjithëpërfshirëse, më të sigurta, reziliente dhe të qëndrueshme (sipas OZHQII dhe ARU). Disponueshmëria e UN-Habitat për të mbështetur institucionet e Kosovës me njohuri, ngritje të vetëdijes, koordinim (midis akterëve të ndryshëm dhe agjendave globale) dhe raportim (konform treguesve të qëndrueshmërisë globale) drejt qasjeve të integruara dhe koherencës së politikës hapësinore u theksua gjithashtu nga Dr. Shipra Narang Suri, Shef i Degës së Praktikave Urbane, Selia e UN-Habitatit.



PREZANTIMET dhe DISKUTIMET

SESIONI 1

RËSTRUKTURIMI INSTITUCIONAL PËR NJË SISTEM MË EFEKTIV DHE TË QËNDRUESHËM TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Roli i qeverive kombëtare drejt planifikimit të qëndrueshëm hapësinor

Dr. Shipra Narang Suri, UN-Habitat

Planifikimi territorial është një proces politik, një proces pajtimi, prioritizimi dhe vendimmarrjeje drejt arritjes së qëllimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore dhe arritjes së ndryshimeve sistemike. Një sistem i planifikimit hapësinor mund të përkufizohet si korniza institucionale e një vendi të caktuar, duke lejuar/rregulluar proceset e shumëfishta dhe komplekse të ndërveprimeve vertikale (ndërmjet niveleve të politikave) dhe horizontale (sektorëve të politikave dhe subjekteve publike e private) që adresojnë organizimin hapësinor të jetës shoqërore. Si i tillë, ai duhet të jetë një proces vendimmarrës integruar dhe pjesëmarrës, i cili përshtatet lehtësisht me ndryshimet e vazhdueshme/dinamike të marrëdhënieve.

Qëndrueshmëria hapësinore lidhet me aftësinë afatgjatë të qyteteve dhe vendbanimeve për të planifikuar me sukses rritjen e urbanizimit të tyre, duke ruajtur rritjen ekonomike, duke ruajtur mjedise të qëndrueshme dhe duke rritur zhvillimin social. Qeveritë mund të arrijnë qëndrueshmëri hapësinore duke udhëhequr formën fizike dhe funksionet e qyteteve dhe rajoneve në mënyrë që të krijojnë qasje të barabartë në vende pune, strehim dhe ndërveprime shoqërore, për të mundësuar ekonomitë e grumbullimit, dhe për të inkurajuar marrëdhënie të qëndrueshme me ekosistemet dhe habitatet natyrore.

Aspekti territorial/hapësinor drejt zhvillimit të qëndrueshëm njihet gjithashtu në Agjendën e vitit 2030, Marrëveshjen e Parisit për veprimet klimatike, Kornizën Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndërtimin e reziliences, Agjendën e Veprimit të Addis Ababa për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjendën e Re Urbane (ARU) për arritjen e një urbanizimi të qëndrueshëm, të planifikuar mirë dhe të menaxhuar mirë. Qytetet dhe vendbanimet e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe rezilente (OZHQ11) mund të arrihen duke promovuar lidhje pozitive midis zonave urbane-rurale dhe politikave të integruara dhe planifikimit për efikasitetin e burimeve, ndryshimin e klimës dhe reziliencën ndaj katastrofave, të zhvilluara përmes proceseve pjesëmarrëse që synojnë përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë (ARU). Rezultatet që dalin kontribuojnë për t'i dhënë fund varfërisë (OZHQ1), për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien (OZHQ3), barazinë gjinore (OZHQ5), qasjen në ujë të pijshëm (OZHQ6), infrastrukturën e sigurt dhe rezilente (OZHQ9), zvogëlimin e pabarazive (OZHQ10), konsumin dhe prodhimin e përgjegjshëm (OZHQ12), dhe shoqërinë përfshirëse dhe institucionet në të gjitha nivelet (OZHQ16).



RASTE STUDIMORE

- Planifikimi hapësinor i Kroacisë është i organizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin e planeve hapësinore të niveleve përkatëse (Plani Zhvillimor Hapësinor Kombëtar, Planet Hapësinore Rajonale, Planet Hapësinore të Qytetit dhe Komunës, etj.), me qëllim të adresimit të sfidave demografike rreth migrimit, sfidat socio-ekonomike dhe çekuilibrat hapësinorë.
- Polonia përdor katër nivele planifikimi (nivele kombëtar, rajonal, të qarkut dhe lokal) të cilat i bazojnë zhvillimet e ardhshme në konceptet kombëtare të zhvillimit hapësinor, të mbështetura nga planet e zonimit rajonal, metropolitan dhe komunal, të cilat duhet të udhëhiqen nga parimet e rendit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke harmonizuar të gjitha konsideratat funksionale, sociale, ekonomike, mjedisore, kulturore, kompozicionale dhe estetike.
- Holanda tradicionalisht ka zbatuar politika gjithëpërfshirëse kombëtare hapësinore, megjithatë në vitin 2006 vendosi t'i japë fund politikave tradicionale rajonale (të cilat sollën pabarazitë rajonale) dhe të vërë theksin në mbështetjen e rajoneve që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik kombëtar, rritjen e konkurrencës dhe promovimin e inovacionit. Planet kombëtare, krahinore dhe themelore të qeverisë komunale u zëvendësuan të gjitha me vizione strukturore, që përmbajnë politika strategjike dhe mënyrën e zbatimit të tyre përmes skemës së zonimit brenda nivelit përkatës të qeverisë.
- Meksika rregullon zhvillimin e saj hapësinor në nivel kombëtar, shtetëror dhe lokal, përmes zhvillimit urban dhe programeve të rendit territorial paralelisht me planifikimin ekologjik.

REKOMANDIMET

- Të formulohet një kornizë e politikave kombëtare që promovon modele urbanizimi të qëndrueshme (përfshirë standardin e përshtatshëm të jetesës dhe rritjen ekonomike),
- Të zhvillohet një kornizë ligjore dhe institucionale mundësuese, e zbatueshme dhe transparente (për të përmirësuar planifikimin territorial dhe ekonomik, koherencën hapësinore, zhvillimin e balancuar rajonal,



rregullimin e tregjeve të tokës dhe pronës, mbrojtjen e mjedisit të ndërtuar dhe natyror, etj.):

- Ligjet duhet të jenë të bazuara në nevojë, kontekst, si dhe në vlerësim adekuat financiar dhe të burimeve njerëzore për zbatimin e tyre,
- Kornizat ligjore duhet të kenë organizim të qartë institucional dhe qeveritar (përfshirë koordinimin horizontal dhe vertikal) për të eliminuar boshllëqet, mbivendosjet, konfuzionin, mungesën e transparencës, llogaridhënien e dobët dhe papajtueshmërinë,
- Proceset e dhënies së pëlqimit duhet të jenë të thjeshta, të shpejta dhe të përballueshme (jo komplekse dhe dekurajuese),
- Të përcaktohen, zbatohen dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme politikat e decentralizimit dhe subsidiaritetit (duke siguruar koherencë midis niveleve sektoriale dhe hapësinore),
- Të forcohet roli, përgjegjësitë, kapacitetet dhe burimet e planifikimit dhe zbatimit të autoriteteve lokale,
- Të promovohet bashkëpunimi ndër-komunal dhe sistemet e mbështetja e qeverisjes me shumë nivele,
- Të bashkëpunohet me shoqatat, rrjetet e planifikuesve profesionistë, institutet kërkimore, shoqërinë civile, sektorin privat (partneritetet, koordinimi, ndërtimi i konsensusit).



DOKUMENTET KRYESORE

- UN-Habitat. 2015. Udhëzuesit Ndërkombëtar për Planifikim Urban dhe Territorial.
- UN-Habitat. 2020. Agjenda e Re Urbane e Ilustruar.





Me rritjen e boshllëqeve të kapaciteteve institucionale të kombinuara me mospërputhjet në kornizat e ndryshme ligjore, planifikimi aktual i territoreve komunale, veçanërisht zonave urbane, po ndodh në mungesë të një Plani Hapësinor Kombëtar të përditësuar dhe një Harte Zonale ende të papërfunduar të Kosovës. Instituti i Planifikimit Hapësinor ka zhvilluar 47 tregues të planifikimit hapësinor që mund të përdoren gjatë hartimit të PZHK-ve; megjithatë, të dhënat e arritshme dhe empirike që do të mundësonin plane hapësinore realiste janë ende të pamjaftueshme (duke u penguar tutje nga ngadalësia e procesit të legalizimit). Këto janë vetëm disa nga boshllëqet që kanë nevojë për vëmendje të veçantë të politikave në nivel kombëtar për të marrë masa të menjëhershme institucionale që janë të nevojshme për të ndërtuar një sistem më efektiv dhe të qëndrueshëm të planifikimit hapësinor në Kosovë.

Paneli i parë përfshiu Liburn Aliu (MMPHI), Shkëlqim Daci (SDC), Elvida Pallaska (UBT), Ilir Gjinolli (UP) and Sami Stagova (UN-Habitat), opinionet e të cilëve u sfiduan më tej, u pasuruan ose u mbështetën nga diskutuesit, përfshirë Luan Nushi (IPH), Eliza Hoxha (AP), Shqiprim Ahmeti (UBT), Lulzim Aliu (DUM, Komuna e Ferizaj), Tomor Qela (UBT), Flutra Zymi (Qytetarët Aktiv).

Diskutimi në panel filloi me pasqyrën e zhvillimit të procesit të planifikimit hapësinor dhe legjislationit në Kosovë, rolin e institucioneve qendrore të planifikimit hapësinor, duke vazhduar me identifikimin e sfidave dhe mospërputhjeve ligjore, masat që duhet të merren për të mbështetur planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm hapësinor, si dhe përfshirjen e akademisë dhe partnerëve të tjerë drejt planifikimit hapësinor gjithëpërfshirës dhe të bazuar në fakte.



SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA:

- Mungesa e përgjithshme e vullnetit politik për ta adresuar siç duhet planifikimin hapësinor, përveç ish-ministrit z. Hetem Çeku dhe ministrit aktual z. Liburn Aliu, i cili duke qenë vetë arkitektë, i jep shpresë planifikimit hapësinor në Kosovë (z. Gjinolli),
- Korniza e re e paqartë ligjore, e cila ka futur logjikën e "të bërit biznes" (z. Aliu, znj. Hoxha), ka prezantuar një mjet të ri të rregullimit të tokës "zonimin" të transpozuar nga sistemi amerikan i planifikimit pa kontekstualizim të duhur (z. Daci, z. Gjinolli), dhe ka hequr planifikimin në nivel qyteti (brenda kufijve të përcaktuar urban) (znj. Pallaska),
- Mungesa e zbatimit të planeve hapësinore në terren, qoftë të zhvilluara bazuar në Ligjin e mëparshëm ose në Ligjin e ri për Planifikimin Hapësinor (z. Stagova),
- Ndarja e paqartë e roleve dhe përgjegjësive brenda institucioneve të planifikimit hapësinor (në nivel qendror, të tilla si DPH-ja dhe IPH-ja) (z. Aliu), me IPH-në e cila fillimisht u krijua për angazhimin e akademisë,
- Kapacitetet e pamjaftueshme institucionale, të pasqyruara në mbingarkesë të stafit dhe kontroll të dobët të cilësisë dhe monitorim të dobët të zbatimit të planeve (z. Daci, z. Gjinolli),
- Ritmi i shpejtë i planifikimit në nivel lokal, i cili ndjek një strategji kombëtare (Plani Hapësinor i Kosovës), që është i vjetruar dhe mund të mos e pasqyrojë realitetin aktual (z. Aliu),
- Cilësia e dobët e planeve hapësinore (të cilëve u mungojnë të dhënat adekuate, nevojat e popullsisë, vlerësimet dhe analizat e duhura) (z. Aliu), duke nxitur kështu ndërtimin e tepërt dhe urbanizimin e pakontrolluar (z. Daci), humbjen e tokës bujqësore dhe lagjet e mbyllura (znj. Pallaska).



REKOMANDIMET KRYESORE TË OFRUARA:

- Të depolitizohen proceset e planifikimit hapësinor (që synojnë zhvillimin afatgjatë) (z. Aliu, znj. Hoxha),
- Të kryhet një studim fizibiliteti mbi nevojën për ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe të bëhen ndryshime evolutive (hap pas hapi), sipas nevojës, duke filluar me Udhëzimet Administrative dhe Normat Teknike (z. Stagova),
- Të decentralizohet vendimmarrja në proceset e planifikimit hapësinor (z. Gjinolli),
- Të fuqizohen komunat në zhvillimin e planeve të tyre hapësinore me staf të brendshëm (z. Nushi), si plane multi-sektoriale, strategjike dhe gjithëpërfshirëse të cilat janë të lehta për t'u kuptuar dhe zbatuar (z. Aliu/K. Ferizaj)
- Të rritet bashkëpunimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal gjatë proceseve të planifikimit hapësinor (shkëmbimi i informatave, të dhënat hapësinore) (z. Gjinolli, z. Nushi, z. Qela),
- Të zhvillohen kapacitetet institucionale duke rritur kapacitetet e tyre kërkimore (p.sh. IPH-të) (z. Qela) dhe duke mbështetur zhvillimin e programeve akademike kombëtare në planifikimin strategjik (z. Gjinolli),
- Të funksionalizohet baza e të dhënave të planifikimit hapësinor në nivel qendror dhe atë lokal (z. Stagova, z. Nushi),
- Të krijohet një sistem monitorimi për zbatimin e planeve në terren (z. Gjinolli, z. Daci) dhe të sinkronizohen aktivitetet e planifikimit në të gjitha nivelet (z. Ahmeti),
- Të bëhen planifikimet sipas trendeve dhe vlerësimeve të rritjes së popullsisë, nevojave për banim/zhvillim, shëndetit të njeriut dhe mjedisit, duke e ndjekur Agjendën e Re Urbane dhe Agjendën Urbane të Bashkimit Evropian (znj. Pallaska),
- Të bëhen planifikimet përmes proceseve gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke bashkëpunuar me profesionistë me përvojë, akademikë dhe studentë premtues në këtë fushë, bizneset, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare (z. Aliu, z. Gjinolli, z. Stagova, znj. Hoxha, z. Ahmeti, znj. Zymeri).

“Zbatimi i ligjit është i nevojshëm sepse shëndeti dhe mirëqenia e qytetarëve janë në pyetje.”

Afrim Lajçi

SESIONI 2

QASJA E PLANIFIKIMIT TERRITORIAL PËR NJË ZHVILLIM MË TË BALANCUAR RURAL-URBAN

Ekspedita në afërsi (ang. Expeditions to the near) (Stambolli Verior)

Dr. Nazli Tümerdem, ETH Zurich

Krahasuar me pjesën jugore të mbipopulluar dhe shumë të industrializuar të Stambollit, pjesa veriore është më pak e populluar dhe dominohet nga pyjet, rezervat e ujit, tokat bujqësore, fermat, zonat ushtarake dhe guroret. Megjithatë, operacionet neoliberale në shkallë të gjerë dhe ato të udhëhequra nga shteti e kanë vënë zonën nën një proces transformues, duke shkaktuar ndikime negative ekonomike dhe ekologjike. Këto megaprojekte janë zhvilluar përmes proceseve ad-hoc me qëllim materializimin e diskursit të shtetit, ndonjëherë duke mos e ndjekur masterplanin e qytetit dhe duke i shpërfillur përfitimet publike dhe opinionet e ekspertëve. Istanbul Walkabouts është një projekt kërkimor performues, projektues dhe pjesëmarrës, i cili përdor shëtitjen në këmbë si një metodologji kritike për eksplorimin, regjistrimin, përfaqësimin dhe rezistimin e peizazheve transformuese të Stambollit verior. Përmes shëtitjeve prej 235km, ky projekt synon t'i eksplorojë dhe kuptojë këto territore dhe ta rrisë ndërgjegjësimin dhe transparencën mbi pasojat e qasjeve të paplanifikuara nga lart-poshtë; kështu, duke ndërtuar një platformë për diskutim dhe diskurs, e cila kritikon operacionet aktuale të paqëndrueshme dhe ofron informata për politikën e ardhshme të urbanizimit përmes qasjeve nga poshtë-lart.



PIKAT KRYESORE PËR T'U MBAJTUR NË MEND

- Të menduarit përtej koncepteve binare (antropocentrike dhe qytetocentrike) si qytet-shtet, urban-rural, qendër-zonë e thellë, brenda-jashtë,
- Mungesa e teorisë koherente urbane, dyshueshmëria dhe mosbesueshmëria e ligjit dhe operacionet neoliberale mund të çojnë në katastrofa ekologjike (siç është Kanali i Stambollit).



DOKUMENTET KRYESORE

- Tümerdem. 2018. Istanbul Walkabouts: Një hulumtim kritik në ecje i Stambollit Verior.
- 1/100.000 Plani Metropolitan i Stambollit (rishikuar në vitin 2009).





Duke pasur parasysh lëvizjen aktuale të qytetarëve aktivë për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të Kosovës, ekosistemet dhe burimet natyrore, është thelbësore që sot – përveç ristrukturimit institucional – të diskutohen qasjet e planifikimit që i kushtojnë vëmendje të veçantë ndërlidhjeve urbane-rurale. Marrëdhëniet urbane-rurale janë jolineare – ndërveprime dhe lidhje të larmishme urbane-rurale në të gjithë hapësirën brenda një vazhdimësie urbane-rurale – duke përfshirë fluksin e njerëzve, mallrave, kapitalit dhe informatave, por edhe midis sektorëve dhe aktiviteteve të tilla si bujqësia, shërbimet dhe prodhimi. Diskursi mbi urbanizimin në Kosovë duhet ta lë pas dikotominë tradicionale dhe të vjetruar mes zonave urbane dhe atyre rurale; për të qenë të qëndrueshme, ato duhet të zhvillohen së bashku, pabarazitë duhet të zvogëlohen dhe hendeku i zhvillimit duhet të kapërcehet. Hapësirat urbane dhe ato rurale janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën në aspektin hapësinor, ekonomik, social dhe mjedisor dhe nuk mund të trajtohen në mënyrë adekuate, nëse ato janë të izoluara nga njëra-tjetra.

Paneli i dytë përfshiu Sali Shoshi (CHWB), Afrim Lajçi, Klodeta Krasniqi (MKRS), Zenel Bunjaku (IADK) and Zana Sokoli (UN-Habitat), mbështetur nga Gyler Mydyti (ETH), Enisa Serhati (UNDP), Gramen Taraku (i pavarur) si diskutues.

Çështjet kryesore të diskutuara përfshinë rolin e zonave rurale, trashëgimisë kulturore, turizmit dhe mobilitetit në zhvillimin e balancuar territorial dhe ekonomik, mbrojtjen e burimeve natyrore, përmirësimin e praktikave bujqësore, mjaftueshmërinë e ushqimit dhe edukimin mjedisor drejt zhvillimit të qëndrueshëm.



SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA:

- Zonat rurale, të konsideruara më parë si vende për ndërveprim me natyrën për arsye shpirtërore, tradicionale, ushqimore dhe artizanale, sot kanë humbur rëndësinë e tyre për shkak të humbjes së mjeteve për jetesë dhe migrimit të popullsisë në zonat urbane (z. Shoshi, znj. Sokoli),
- Rreth 60% e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike të Kosovës (nga gjithsej 990 monumente arkitekturore dhe rreth 400 vende arkeologjike) gjendet në zonat rurale, me shumë pak informata për ekzistencën e tyre (z. Shoshi),
- Mungon një pasqyrë e qartë e sistemit të vlerave të trashëgimisë në Kosovë (znj. Krasniqi),
- Burimet e kufizuara ujore (rreth 2000 m³/kokë banori, 4 miliardë rezerva/vit), më të ultat në rajon, të cilat pritet të ulen edhe më shumë për shkak të ndryshimit të klimës; pa menaxhim të duhur, duke rezultuar në dëmtim të shtretërve të lumenjve dhe ndotje të ujit (z. Lajçi),
- Bujqësia kontribuon me rreth 10% të BPV-së (z. Bunjaku), megjithatë, ajo gjithashtu është një sektor shumë ndotës,
- Planet e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban janë një koncept relativisht i ri në Kosovë, i cili nuk kërkohet me ligj, por zhvillohet nga komunat me iniciativë të tyre (znj. Sokoli),
- Statistika të vjetruara dhe jo të besueshme, p.sh. përqindja e popullsisë urbane kundrejt asaj rurale (znj. Mydyti).



REKOMANDIMET KRYESORE TË OFRUARA:

- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstytucional (me MMPHI-në, MKRS-në dhe MBPZHR-në) si dhe me shoqërinë civile për të mbështetur mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (përfshirja në planet hapësinore), zhvillimet përkatëse infrastrukturore (performanca mjedisore dhe zhvillimi i zonave rurale) (z. Shoshi, znj. Krasniqi),
- Të ndërlihet trashëgimia kulturore me kujtesën kolektive, kulturën, rininë dhe turizmin (znj. Krasniqi),
- Të ekspolorohet potenciali për zhvillimin e mëtejshëm turistik të grupeve rurale (fshatrat ose rajonet me karakteristika të ngjashme) të identifikuar në të gjithë Kosovën nga CHwB, siç janë minierat dhe përpunimi i metaleve (Artana, Janjeva, Mitrovica), prodhimi i verës (që shtrihet nga Suhareka deri në Gjakovë), kultivimi i frutave (Istog), dhe produktet e brumit (bukë), dhe grupeve etno-kulturore (Has) (z. Shoshi),
- Të trajtohen ujërat e zeza urbane dhe industriale duke siguruar impiante për trajtimin e ujit nëpër shtatë zonat më të mëdha urbane (dhe më gjerë) deri në vitin 2025 (z. Lajçi),
- Të mbrohen burimet ujore (nga ndotja dhe degradimi), të definohen zonat e përcaktuara për grumbullimin e liqeneve dhe masat e mbrojtjes nga përmytjet në planet hapësinore (z. Lajçi),
- Të përfshihen komunitetet rurale në proceset e planifikimit hapësinor (z. Bunjaku),
- Të zgjerohen rregullat e zonimit, duke mundësuar zhvillimin e përzier rural dhe turistik aty ku ka potencial (z. Bunjaku),
- Të sigurohet infrastrukturë dhe shërbime adekuate për vendbanimet rurale për ta zvogëluar migrimin rural-urban dhe për ta mbështetur zhvillimin e përgjithshëm (z. Bunjaku),
- Të sigurohen sisteme të qëndrueshme të mobilitetit, duke siguruar transport publik urban (si në Prishtinë), shtigje për biçikleta dhe ecje, hapësira adekuate për parkim dhe hapësira publike përmes zhvillimit të PMQU-ve (si në rastet e Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore) (znj. Sokoli),
- Të mbështeten proceset e planifikimit ndër gjenerata, përmes të cilave vizionojmë të ardhmen që duam (znj. Sokoli),
- Të fuqizohet roli i universiteteve në udhëheqjen e diskursit shkencor dhe atij filozofik mbi territorin dhe hapësirën, konceptet urbane dhe ato rurale (znj. Mydyti),
- Të fuqizohen komunitetet (qofshin ato urbane apo rurale) në vetëorganizim, shkëmbim të njohurive dhe vendimmarrje, pa prituri vetëm nga institucionet (znj. Mydyti),
- Të mbështetet veprimi lokal për klimën përmes inventarit të gazrave serrë dhe strategjive të zhvillimit të gjelbër (siç është pilot projekti Urban NAMAs i zbatuar nga UNDP në Prizren) (znj. Serhati),
- Të finalizohet plani hapësinor për Parkun Kombëtar 'Bjeshkët e Nemuna' (z. Taraku).

SESIONI 3

PLANIFIKIMI I INTEGRUAR HAPËSINOR, MENAXHIMI I TOKËS DHE BANIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Roli i planifikimit territorial për banim dhe qytete të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë

Dr. Jennifer Duyne Barenstein, ETH Zurich Wohnforum

Banimi i përshtatshëm përcaktohet nga shtatë kritere: siguria ligjore e pronësisë, disponueshmëria e shërbimeve, përballueshmëria financiare, banueshmëria, qasshmëria, vendndodhja dhe përshtatshmëria kulturore. Pa infrastrukturën bazë të shërbimeve, të tilla si uji, kanalizimet, energjia, transporti etj., asnjë lloj banimi nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm. Mungesa e infrastrukturës ka implikime ekonomike, mjedisore, shëndetësore dhe të jetesës. Në mbarë botën, miliona njerëz nuk kanë qasje në këto shërbime dhe janë të privuar nga banimi i përshtatshëm për shkak të planifikimit të shkëputur territorial; kështu, duke i rritur pabarazitë dhe përjashtimin social.

Kosova gjithashtu vuan nga çështjet territoriale siç është zgjerimi i shpërndarë urban (ang. urban sprawl), e cila ka kontribuar në humbjen e tokës bujqësore, degradimin e ekosistemit, zgjerimin e infrastrukturës dhe ndikimet socio-ekonomike. Komplekset e banimit social janë të ndara dhe të ndërtuara në periferi urbane.



RASTE STUDIMORE

- Çështjet e banimit në qytetin e Cyrihut adresohen përmes partneriteteve publike-private, në të cilat raste, qyteti u jep me qira tokën publike kooperativave të banimit (deri në 60-70 vjet) për të ndërtuar banesa me cilësi të lartë brenda qendrës së qytetit (shoqëruar me shërbime, hapësira publike adekuate, dhe kritere të tjera që mbështesin jetesën adekuate dhe të qëndrueshme).
- Banimi kooperativ nuk është banim social pasi nuk i ndan njerëzit. Një qasje e tillë mbështet dendësimin e qytetit, menaxhimin efikas të tokës, uljen e bllokimit të trafikut dhe planifikimin efikas të infrastrukturës.
- Qyteti i Cyrihut është zotuar ta rrisë përqindjen e banorëve të qyteteve që jetojnë në banesa jofitimprurëse në 1/3 deri në vitin 2050.



REKOMANDIMET

- Të integrohet planifikimi territorial me zhvillimet e banimit (duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe ofrimin e shërbimeve),
- Të investohet në infrastrukturë të transportit dhe shërbime (për t'i zvogëluar shpenzimet e banorëve të qytetit për mobilitet, për ta rritur mirëqenien e tyre dhe për ta mbrojtur mjedisin),
- Të integrohen banorët e banimit social brenda të njëjtës zonë banimi të ndërtuar për qytetarët e tjerë (për ta shmangur marginalizimin hapësinor të atyre me të ardhura më të ulëta).

DOKUMENTET KRYESORE

- UN-Habitat. 2009. E drejta për banim adekuat.





Zhvillimi i balancuar territorial në Kosovë do të thotë të kesh vullnet politik dhe kapacitet institucional, duke përdorur mjete adekuate të planifikimit dhe duke u përpjekur të kesh hapësira të zhvilluara në mënyrë kompakte dhe zona me përdorim të përzier që kanë infrastrukturë adekuate dhe mobilitet, që janë lehtësisht të qasshme për të gjitha grupet e shoqërisë, që ofrojnë banim fleksibil dhe të përbalueshëm/banim me shërbime të qëndrueshme dhe mundësi të përshtatshme jetese. Në këtë drejtim, planifikimi dhe menaxhimi i integruar i tokës janë mjete thelbësore që mund t'i ndihmojnë autoritetet publike t'i identifikojnë dhe shmangin zonat e cënueshme, të sigurojnë të drejtat e pronësisë, të regjistrojnë pronën dhe të mundësojnë një treg efikas të tokës. Më konkretisht, këto mjete mund të shihen si bazë për ndërmarrjen e stimujve të zhvillimit në mbështetje të krijimit të banimit social dhe të përbalueshëm në tregje të parregulluara (siç është Kosova), por edhe për të siguruar rritje të qëndrueshme, fleksibile, sociale dhe ekonomike.

Panelistë për këtë sesion ishin Mimoza Sylejmani (UBT), Besnike Koçani (UN-Habitat), Driton Tafallari (MMPHI), Uragan Alija (UBT), Nita Luci (UP), kurse diskutues ishin Banush Shyqyriu (UBT), Merita Dalipi (MMPHI), Visar Perani (IFC).

Temat e diskutuara gjatë seancës trajtuan mungesën e të dhënave të sakta dhe profileve të duhura të banimit, mungesën e tokës publike, mjeteve të mundshme të planifikimit dhe projektimit që do të mund të përdreshin për të kuptuarit më të mirë të nevojave të shoqërisë për shërbimet bazë dhe banimin, instrumenteve të mundshme inovative financiare, dhe potencialit për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve përmes planifikimit të integruar hapësinor.

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA:

- Kapacitetet e pamjaftueshme të planifikimit hapësinor brenda institucioneve qendrore dhe atyre lokale (për hartimin e dokumenteve strategjike, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave) (z. Agaj), me IPH-në e cila ka vetëm 13 persona (dy prej tyre punojnë në pjesën veriore të Kosovës),
- Ekzistojnë vështirësi në punën me partnerë të ndryshëm nëpër institucione (znj. Koçani),
- Mungesa e të dhënave dhe informatave (përfshirë të dhënat cilësore nga terreni, matjet dhe parashikimet e duhura demografike) veçanërisht për banimin (z. Tafallari, znj. Koçani),
- Mungesa e një përkufizimi të qartë (brenda ligjeve/rregulloreve ekzistuese) mbi banimin social, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm,
- Rreth 60% e të dhënave të lidhura me banimin mbledhen manualisht (në letër ose Excel), sipas vlerësimit të shpejtë të nevojave për banim, të kryer nga UN-Habitat, në komunat e Kosovës (znj. Koçani),
- Mungesa e ndarjes së qartë të përgjegjësisë në lidhje me banimin (mungesa e sektorëve të banimit ose banimit social brenda komunave, ku Ministria mbetet trajtuesja kryesore e çështjes) (znj. Dalipi),
- Mungesa e monitorimit të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në terren,
- Prania e shtëpive/apartamenteve të zbrazëta në treg.



REKOMANDIMET KRYESORE TË OFRUARA:

- Të krijohen partneritete me sektorin privat, me role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë (p.sh. institucionet publike sigurojnë tokën, ndërsa sektori privat e zhvillon atë në përputhje me nevojat publike ose lë mënjanë njësitë e banimit për grupet me të ardhura më të ulëta) (z. Alija, znj. Sylejmani, z. Perani),
- Të pozicionohet sektori i banimit si një komponent qendror në dokumentet strategjike të nivelit qendror dhe atij lokal (veçanërisht PZHK-të), me qëllim të mbështetjes së familjeve me status më të ulët socio-ekonomik që nuk janë në gjendje ta përballojnë çmimin e tregut (z. Tafallari),
- Të adresohet nevoja për krijimin e banesave të reja të përballueshme, por edhe përmirësimin e cilësisë së atyre ekzistuese (znj. Sylejmani),
- Të rritet disponueshmëria e banimit duke zhvilluar apartamente të lira që janë në dispozicion (z. Shyqyriu),
- Të silltet nocioni i "planifikimit të integruar" në kontekstin e proceseve ideologjike të transformimit (znj. Luci),
- Të ripërcaktohen konceptet e kufijve urban/rural, duke menduar për "planifikimin e integruar" si një proces ideologjik transformimi (duke u bazuar në debatin mbi Antropocenin, duke sjellë natyrën në qytet, duke i trajtuar qytetet si zona të unifikuara) (znj. Luci),
- Të harmonizohet terminologjia dhe përkufizimi i banimit në kornizën ligjore përkatëse dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura (znj. Koçani),
- Të rriten kapacitetet kërkimore në Kosovë (duke rritur fondet e dedikuara për hulumtime në fushën e planifikimit, banimit, etj. nga MASHT-i) (znj. Koçani),
- Të shfrytëzohen aftësitë e brezit të ri në teknologji në krijimin e platformave dhe softuerëve të rinj për përmirësimin e proceseve të mbledhjes së të dhënave (znj. Koçani),
- Të krijohen grupe teknike (ndërsektoriale) të punës për integrimin dhe harmonizimin e produkteve, aktiviteteve/projekteve të ndryshme (planifikimi, banimi, asetet e trashëgimisë kulturore, etj.) (znj. Koçani),
- Të zhvillohet më tej baza e të dhënave të trashëgimisë kulturore (shënimi hapësinor i shtigjeve malore, trashëgimia kulturore dhe asetet arkeologjike dhe zonat përkatëse të mbrojtjes, asetet bujqësore, etj.) (znj. Koçani).

**"Planeri urban i famshëm vendor, Rexhep Luci, dikur ka thënë
"Për të gjithë ata që po e shkatërrojnë qytetin, qyteti do të
marrë hak". Duke u bazuar në këtë, unë them "Për të gjithë ata
që po e shkatërrojnë planetin, planeti do të marrë hak."**

Nita Luci



REZULTATET dhe HAPAT E ARDHSHËM



Të zgjerohet diskutimi me qeveritë lokale, ofruesit e shërbimeve, praktikuesit, sipërmarrësit, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit lokal.

Të përmirësohen marrëdhëniet me akademinë dhe institucionet kërkimore, si dhe me ofruesit e të dhënave, për ta mbështetur planifikimin e bazuar në shkencë dhe në fakte:



- Të investohet në ngritjen e kapaciteteve brenda institucioneve të planifikimit hapësinor,
- Të investohet në programet kërkimore,
- Të zhvillohen dhe pasurohen më tej bazat e të dhënave të planifikimit hapësinor,

Të bëhet një studim fizibiliteti mbi përparësitë dhe mangësitë e kornizës aktuale të legjislacionit të planifikimit hapësinor:



- Të vlerësohet zbatimi i dokumenteve aktuale të planifikimit hapësinor në terren,
- Të identifikohen pengesat, duke përcaktuar qartë pse ato nuk mund të adresohen nga korniza ligjore aktuale dhe çfarë nevojitet për t'i ndryshuar ato (të mbështetura me të dhëna faktike ose raste të dëshmuara),

Të analizohet tranzicioni i vendeve të tjera të praktikave të planifikimit hapësinor, duke kontekstualizuar përparësitë dhe mangësitë në kontekstin e Kosovës.



Nëse vërtetohen si të nevojshme:



- Të nisët procesi i rregullimit të kornizës ligjore duke marrë parasysh qasjet praktike, të tilla si ndryshimet e Udhëzimeve Administrative dhe Normave Teknike përkatëse (si një proces evolucionar/transformues, e jo si një proces i ngutshëm),
- Të ndërmerren ndryshime strukturore brenda Ministrisë për ta shfrytëzuar më mirë rolin dhe operacionet e saj (p.sh. ripërcaktimi i rolit të Institutit për Planifikim Hapësinor, potencialisht si ndërmjetës midis qeverisë dhe akademisë).



2021

Raporti i Simpoziumit:

E ARDHMJA E PLANIFIKIMIT TERRITORIAL NË KOSOVË



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
në partneritet me UN-Habitat Kosova